



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:060852
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05501292

PPP.nr.20/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Sami Gashi, duke vendosur në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, B.Sh., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson, av. H. Sh., nga Prishtina rr “.....” objekti, të paraqitur kundër debitorës së përmbarimit, Kompania e Sigurimeve, “P.....”, me numër biznesi, me adresë në rr., nr....., të cilën e përfaqëson pronari, N.E., nga Prizreni, e për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2562/2017 i datës 23.02.2021, e për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 47,210.66 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara të qytetarëve në bankat e Kosovës pa afatizim dhe destinim të caktuar të llogaritura nga data 21.01.2014 e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej, 2,106.80 € në emër të kompenzimit të dëmit, si dhe shpenzimet e caktuara të përmbarimit, i lejuar me Urdhrin për përmbarim, P.nr.47/24 të datës 17.01.2024 të Përmbaruesit privat, Flamur S. Bogaj nga Prishtina, jashtë seancës dëgjimore, me datë 25.03.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorës së përmbarimit, Kompania e Sigurimeve “P.....”, me seli në Prizren, i ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.47/24 të datës 17.01.2024 të Përmbaruesit privat, Flamur S. Bogaj nga Prishtina, dhe i njëjti urdhër për përmbarim, **MBETET në fuqi.**

A r s y e t i m

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat, Flamur S. Bogaj nga Prishtina, me Urdhrin e tij për përmbarim, P.nr.380/2022 të dt.07.04.2022, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorit B.Sh., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqësonë, av. H. Sh., nga Prishtina, të paraqitur kundër debitorës së përmbarimit, Kompania e Sigurimeve, ”P..... ”, me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson pronari, N.E., nga Prizreni, e për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2562/2017 i datës 23.02.2021, e për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 47,210.66 euro, me kamatë ligjore si për

mjetet e deponuara të qytetarëve në bankat e Kosovës pa afatizim dhe destinim të caktuar të llogaritura nga data 21.01.2014 e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej, 2,106.80 € në emër të kompenzimit të dëmit material, si dhe shpenzimet e caktuara të përmbarrimit,

Pala debitore, pas pranimit të urdhrin për përmbarrim, me datë 09.02.2024, brenda afatit ligjor me datë 14.02.2024, kundër këtij Urdhri për përmbarrim, ka paraqitur prapësim, e duke e kundërshtuar urdhrin e përmbarruesit privat, me pretendimin se shkresat drejtuar kompanisë tonë janë adresuar gabimisht, pasi që kompania jonë nuk i ka obligim kreditorit as që ka kontraktuar ndonjë marrëveshje me kreditorin pasi që ndërmarrja shërbyese ka emrin tregtar Kompania e Sigurimeve “P.....”, N.E., B.I, ndërsa urdhri përmbarrimor dhe propozimi për përmbarrim i kreditorit i adresohet N.E., B.I – Ndërmarrje Sigurimi “P.....”, andaj nga këto të cekura, propozimi për përmbarrim duhet të refuzohet ngase në Aktgjykimin AC.nr.2562/17 është e detyruar Kompania e Sigurimeve “P.....” në Prizren, e jo ashtu si pretendohet në propozimin për përmbarrim N.E., B.I – ndërmarrje Sigurimi “P.....”. Ndër të tjera, debitori i përmbarrimit e ka kontestuar propozimin për përmbarrim si të parashkruar. Nga këto pretendime, ka kërkuar nga Gjykata që prapësimi i debitorit të aprovohet në tërësi si i bazuar ndërsa propozimi për përmbarrim të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Me datë 16.02.2024, kreditori ka paraqitur përgjigjen në prapsim, duke e kundërshtuar në tërësi, pasi që i njëjti nuk paraqet gjendjen reale dhe ka tendencë të paraqet një situatë e cila në fakt nuk ekziston, pasi që në faturat – kuponët e dorëzuar nga debitori, shënojnë të dhënat e biznesit me emrin N.E., B.I. – Ndërmarrje Sigurimi “P.....”, Prizren me numër biznesi, ndërsa në kuponin tatimor 002200 të datës 13.03.2010, shënohet Kompania e Sigurimit P..... me emër të biznesit N.E., B.I. me numër biznesi dhe numër fiskal, ashtu që bëhet fjalë për të njëjtin ndërmarrës këtu debitorin e përmbarrimit. Andaj arsyet e prapësimit për shkak të mungesës së legjitimitetit të palës debitorë janë të paqëndrueshme dhe kanë tendencë për lajthimin e Gjykatës. Po ashtu kreditori ka kontestuar thirrjen në parashkrim të debitorit, pasi që kërkesa nuk e ka arritur afatin e parashkrimit, duke u bazuar në dispozitat e LMD-së.

Kështu kjo gjykatë, si organ përmbarrues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se prapësimi i debitorës, Kompania e Sigurimeve, “P.....”, me seli në Prizren, me pronar N.E., B.I, i ushtruar kundër urdhrin për përmbarrim, P.nr.47/24 të datës 17.01.2024 të Përmbarruesit privat, Flamur S. Bogaj nga Prishtina, është i pa bazuar.

Me shikim në shkresat e lëndës së përmbarrimit, P.nr.47/24 të Përmbarruesit Privat, Flamur S. Bogaj nga Prishtina, gjykata si organ kompetent për vendosje për prapësimet e ushtruara kundër urdhrave për përmbarrim të përmbarruesit privat, si në rastin konkret, vërtetoi faktin se kreditori i përmbarrimit, propozimin e tij për përmbarrim, e ka bërë për përmbarrimin e dokumentit të përmbarrimit – aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.2562/2017 i datës 23.02.2021, e për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 47,210.66 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara të qytetarëve në bankat e Kosovës pa afatizim dhe destinim të caktuar të llogaritura nga datë 21.01.2014 e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2,106.80 € në emër të kompenzimit të dëmit material, si dhe shpenzimet e caktuara të përmbarrimit, i lejuar me Urdhrin për përmbarrim, të përmbarruesit kompetent, e me propozimin e mjeteve të caktuara të përmbarrimit të parapara sipas LPP-së, për realizimin e detyrimit në të holla, si në rastin konkret.

Në kuadër të saj, se mbi çfarë baze caktohet përmbartimi, se çka përbën dokument të përmbartimit dhe mënyrën e zbatimit të një vendimi gjyqësor, si dokument i përmbartimit, për kërkueshmërinë e një kredie në të holla, për përshtatshmërinë për përmbartim të tij, bëhet fjalë në nenin 21, 22 par.1 pika 1, 23, 27, 36, dhe nenit 38 të LPP-së, e në rastin konkret, dokument i përmbartimit, është vendim gjyqësor, si dokument përmbartimor dhe i cili, propozimit për përmbartim, nga pala kreditore, i është bashkangjitur në origjinalin e tij, ky vendim gjyqësor, është bërë i ekzekutueshëm, se në këtë vendim gjyqësor, ceket afati për përmbushjen e detyrimit në holla, e ka cilësinë e dokumentit të përmbartimit, si dhe në këtë dokument të përmbartimit, janë treguar palët në procedurë, objekti, mjete, shuma e detyrimit të kërkua në të holla dhe koha e përmbushjes së detyrimit në të holla, pra ky dokument i përmbartimit, i përmban të gjitha të dhënat të cilat duhet t'i ketë një dokument i përmbartimit, e përkitazi me prapësimin si mjet i rregullt juridik në procedurën e përmbartimit, i paraqitur kundër një vendimit të organit përmbartues, e në rastin konkret kundër një urdhri të lartë cekur për përmbartim të përmbartuesit privat, bëhet fjalë në nenin 69 të LPP-së, derisa për shkaqet e parapara për prapësim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së, e pala debitore në prapësimin e asaj është bazuar në atë se, debitori nuk ka të bëjë me këtë obligim me të cilën thirret kreditori, dhe as që ka ekzistuar kjo ndërmarrje për të cilën thirret kreditori, mirëpo ky pretendim i palës debitore, është i pa bazuar pasi që, në vendimin gjyqësor në fjalë, si dokumenti i përmbartimit, ceket saktë emri i debitorit ashtu që bëhet fjalë për të njëjtin subjekt tregtar, andaj arsyet e dhëna në prapësimin e palës debitore, të ushtruar kundër urdhrit për përmbartim, të përmbartuesit privat, nuk janë të bazuara në nenin 71 të LPP-së, dhe me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë prapësimin e debitorës së përmbartimit, të ushtruar kundër Urdhrit për përmbartim, të përmbartuesit privat, e refuzoi si të pa bazuar dhe të njëjtin Urdhër për përmbartim, e la në fuqi.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 5, 13, 21, 22, 23, 24, 27, 36, 67, 69, 70, 71, 72, 73, 74, dhe 77 të LPP-së, lidhur me nenin 8, 9, 10, 11 dhe nenin 12 të Ligjit, nr.05/L-118 të dt.18.4.2017 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit, nr.04/L-139 të dt.20.12.2012 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.20/2024, me datë 25.03.2024

Gjyqtari,
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankesë brenda afatit prej **7 (shtatë) ditëve**, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.